

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

STUDIMET POSTDIPLOMIKE-MASTER

DEPARTAMENTI CIVIL



TEZA MASTER

Ngjajshmëritë dhe dallimet ndërmjet zgjidhjes dhe anulimit të kontratës

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Bashkim Preteni

Kandidatja:

Majlinda Sahiti

Prishtinë, Dhjetor 2024

ABSTRAKT

Kontratat kanë rol të rëndësishëm për rregullimin e drejtave dhe detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet palëve, mirëpo hasim dhe raste të cilat për shkaqe të parapara me ligj anulohen apo zgjidhen. Për problematikat që i hasim në rastet e këtilla në këtë punim i kam shtjelluar se cilat janë ngjajshmëritë dhe dallimet ndërmjet zgjidhjes dhe anulimit të kontratës.

Pikërisht, këtu qëndron edhe rëndësia e trajtimit të kësaj teme, gjegjësisht ky punim ka trajtuar “Ngjajshmëritë dhe dallimet ndërmjet zgjidhjes dhe anulimit të kontratës” në bazë dhe të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili është në fuqi. Në këtë punim diskutohet rreth përkufizimeve, shkaqeve, përmes një hulumtimi dallimet dhe ngjajshmëritë sipas ligjit në fuqi, si dhe janë trajtuar edhe raste nga praktika gjyqësore që punimi të jetë sa më i kuptueshëm për lexuesit.

Në këtë punim janë përdorur metoda të kombinuara duke përfshirë përdorimin e metodave komparative, analitike, sintezës, metodës juridike, njëkohësisht, kërkimi doktrinar është aplikuar nga mbledhja dhe sistemimi i librave, Nga ky hulumtim është arritur konkludimi se përmes studimit dhe analizës së kësaj teme si dhe rasteve nga praktika e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, ky hulumtim shkencor do të ndihmojë lexuesit që të udhëzohen më shumë për ngjajshmëritë dhe dallimet ndërmjet zgjidhjes dhe anulimit të kontratës.

Fjalët kyçe: Kontrata, ngjajshmëri, dallime, zgjidhje, anulim.